



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.431/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi, Kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me apelet e paraqitura nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Adem Salihaj, nga subjekti politik LDK, Dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 07.11.2019, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuar apelet Anr.431/2019, Anr.432/2019 të paraqitura nga Adem Salihaj, kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik LDK, Dega në Ferizaj, në të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në VV2515D/03D dhe 2522D/01R, Komuna Ferizaj.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet me datën 07.11.2019 në ora 14:35, nga Adem Salihaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik LDK, në të cilën apele është pretenduar se në vendvotimin me numër 2555D/01R, dyshon se nuk janë numëruar votat mirë, sepse te numri i tij 50 me të cilën është kandiduar janë shënuar vetëm 3 vota , gjë që është në disproporcion të madh në vendvotimin tjetër të kësaj qendre dhe të qendrave tjera. Në vendvotimin 2515D/03D pretendon se iu kanë shënuar vetëm 6 vota me të cilën është në disproporcion të madh me kandidatët tjerë nga Ferizaji, të cilën kanë marrë 8 herë më shumë vota se vet ai, gjë që nuk ndodhë në vendvotimet tjera.

Paraqitësi i apeleve ka kërkuar nga PZAP-i që të rinumërohen votat e tij në këto dy vendvotime.

Paneli në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartëcekura dhe i trajton si një apel të evidentuar me Anr. 431/2019, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase paraqitësi i apeleve kërkon që të rinumërohen këto dy vendvotime me numër VV2515D/03D dhe 2522D/01R, në komunën e Ferizajit, sepse nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), i njëjti në këto dy vendvotime posedon vetëm 9 vota, me të cilën sipas paraqitësit të apeleve është në disproporcion të madh me kandidatët tjerë.

Mirëpo, pretendimet në apele me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në këto dy vendvotime VV, iu janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, prandaj lidhur me këtë çështje Paneli, apelin e paraqitur e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, paneli, konstatoi se pretendimet në apele janë të pabazuara ngase paraqitësi i apeleve nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar dyshimet e tija të pretenduara në apele edhe pse barra e të provuarit bie mbi paraqitësin e apeleve, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në apele.

Rrjedhimisht PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apele, konstaton se apelet në fjalë janë të pabazuara dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelet e parashtruara i refuzoi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.431/2019 më datën 08.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaçi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.